



AGJENCIA KOMBËTARE E FINANÇIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E FINANÇIMIT TË ARSIMIT TË LARTË
AKFAL



SKEMA E KREDITIMIT STUDENTOR

LIGJ
Nr.80/2015
“Për arsimin e lartë dhe
kërkimin shkencor në
institucionet e arsimit të lartë
në Republikën
e shqipërisë”
Neni 11

a) mbështetjen e veprimtarisë së IAL publike:
mësim-dhënia, kërkimi shkencor dhe
pjesëmarrja në çështjet e menaxhimit
akademik dhe administrativ;

b) mbështetjen me bursa studimi për
studentët e shkëlqyer, studentët në
programet e studimit në fusha prioritare dhe
studentët nga shtresa sociale në nevojë;

c) garantimin e skemës së kredive
studentore.

INSTITUCIONI PËRGJEGJËS

- Pika 2 e VKM nr.397, datë 3.5.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL):
- AKFAL është institucioni përgjegjës për garantimin e skemës së kredive studentore, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

QËLLIMI I KREDITIMIT STUDENTOR


VKM nr.440
datë
19.07.2023
“Për
përcaktimin
e skemës së
kreditimit
studentor”.

Mbështetja e studentëve që nuk kanë mundësi financiare për të ndjekur studimet

Mundëson studentin, që nëpërmjet instrumentit financiar të kredisë të mbulojë shpenzimet dhe kostot e studimeve të larta, në një IAL publike.

Incentivon pjesëmarrjen e fondeve jo-publike në arsimin e lartë, për të rritur aksesin në arsimin e lartë.

SUBJEKTI PËRFITUES



Përzgjedhja e Bankës të nivelit të dytë, me të cilën AKFAL do të lidhë marrëveshjen e financimit të një pjese të normës së interesit të kredisë.

Përzgjedhja e studentëve, të cilët do të përfitojnë nga skema e kreditimit studentor.

Hartimi, miratimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Financimit AKFAL-BANKË.

Vlerësimi i kushteve të skemës së kreditimit, të kontratës së kredisë *Bankë-Student* dhe financimi i një pjese të normës së interesit të kredisë.

1. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË BANKËS TË NIVELIT TË DYTË

1.

Hartimi i Udhëzuesit “Për planin e veprimit të AKFAL për kreditë Studentore të përcaktuar në vendimin nr.440, datë 19.07.2023 të Këshillit të Ministrave”, protokolluar me nr.81/2 prot., datë 31.08.2023.

2.

Informimi i MAS, nëpërmjet shkresës nr.81/3 prot., datë 16/10/2023, mbi matricën e veprimeve që AKFAL do të ndjekë, për garantimin e skemës së kreditimit studentor, për vitin akademik 2023-2024.

3.

3.Dërgimi me anë të shkresës nr. 81/5 prot., datë 26.10.2023, i Njoftimit Publik “Për Bankat e Nivelit të dytë për të paraqitur oferta për normën e interesit për Kreditë Studentore”, së bashku me dokumentacioni përkatës, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare,

4.

4.Publikimi në Buletin e Njoftimeve Zyrtare nr.38, datë 30.10.2023 Njoftimi Publik, “Për Bankat e Nivelit të dytë për të paraqitur oferta për normën e interesit të Kredisë Studentore”, në të cilin AKFAL fton çdo bankë të nivelit të dytë të paraqesë ofertën e saj, dorazi ose me postë, të mbyllur në zarf, në adresë të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

6.

5.Hartimi i Udhëzuesit “Për planin e veprimit të AKFAL për kreditë Studentore të përcaktuar në vendimin nr.440, datë 19.07.2023 të Këshillit të Ministrave”, protokolluar me nr.81/2 prot., datë 31.08.2023.

7.

6.Njoftimi me anë të shkresave nr. 200/1-200/11 prot., datë 04.11.2023, bankat e nivelit të dytë, mbi publikimin e njoftimit publik në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare datë 30.10.2023, nëpërmjet të cilit AKFAL fton Bankat e Nivelit të dytë të interesuara, të paraqesin ofertë për normën e interesit për kreditë studentore, sipas kushteve të skemës së kreditimit studentor, të përcaktuara në VKM-në nr. 440, datë 19.07.2023.

7.

Dërgimi i shkresave nr. 217-217/11 prot., datë 01.12.2023, Bankave të nivelit të dytë dhe sekretarit të përgjithshëm të Shoqatës Shqipëtare të Bankave, për të marrë pjesë në takim informues, të organizuar nga AKFAL, mbi sqarimin e elementëve procedural të procesit të skemës së kreditimit studentor.

8.

Realizimi i takimit informues me bankat e nivelit të dytë si dhe sekretarin e përgjithshëm të Shoqatës Shqipëtare të Bankave, më datë 07.12.2023. Në këtë takim u bë një prezantim i shkurtër mbi themelimin, shtyllat e funksionimit dhe rolin e AKFAL në këtë sistem kreditimi, si dhe sqarimi i elementëve procedural të procesit të skemës së kreditimit studentor.

9.

Pritja e ofertave për normën e interesit të kredisë studentore të ofruara nga Bankat e Nivelit të dytë. Bankat e nivelit të dytë brenda datës 29.12.2023(është pritur dhe posta e datës 03.01.2024), kanë paraqitur pranë AKFAL, ofertat për normën e interesit.

10.

Dërgimi i shkresës nr. 220/2 prot., datë 12.12.2023, Bankës së Shqipërisë, për vënien në dispozicion të një specialisti/eksperti për të marrë pjesë si anëtar në Komisionin e Vlerësimit dhe Renditjes, të ofertave të bankave të nivelit të dytë për normën e interesit.

11.

Dërgimi i shkresës nr. 220/1 prot., datë 12.12.2023, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për vënien në dispozicion një specialist/ekspert, për ta përfshirë si anëtar në Komisionin e Vlerësimit dhe Renditjes.

12.

12.Mbledhja e Komisionit të Vlerësimit dhe Renditjes e ngritur me Urdhërin nr.2 datë 04.01.2024 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe renditjes së ofertave për normën e interesit të kredisë studentore, të paraqitura nga bankat e nivelit të dytë”, më datë 5.01.2024, ora 10:30, për hapjen, vlerësimin dhe renditjen e ofertave.

Kushtet që duhet të përmbajë kontrata e kredisë Bankë-Student (pika 3 e VKM):

- *kredia studentore jepet pa kolateral fizik;*
- *kredia studentore jepet për mbulimin e kostove vetëm për ndjekjen e një programi studimi;*
- *financimi i kredisë bëhet me këste, të paktën dy herë në vit, dhe financimi i çdo kësti realizohet vetëm pas konfirmimit nga institucioni i arsimit të lartë, që studenti kredimarrës ka shlyer tarifën vjetore të shkollimit të vitit akademik dhe ka frekuentuar procesin mësimor;*
- *detyrimi i shlyerjes së kredisë, përfshirë principalin dhe interesin e kredisë nga studenti kredimarrës, fillon jo më herët se 3 (tre) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të parë; jo më herët se 2 (dy) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të dytë dhe jo më herët se 5 (pesë) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të integruar të ciklit të dytë;*
- *norma e interesit të kredisë studentore të jetë më e ulët se norma mesatare e interesit për kreditë konsumatore, të dhëna nga institucioni kredidhënës për 2 (dy) vitet e fundit, përfshirë vitin në të cilin jepet kjo kredi;*
- *norma e interesit të kredisë të jetë e pandryshueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së kredisë.*

Kriteri për vlerësimin e ofertës fituese

- Norma më e ulët e ineresit të ofruar për kreditë studentore.

Dokumentet bashkëngjitur ofertës duhet të dorëzohen të noterizuara, sipas anekseve më poshtë:

- Aneksi 1: Lista e dokumenteve të nevojshme për aplikim;
- Aneksi 2: Formulari tip i aplikimit;
- Aneksi 3: Deklarata për pranimin e kushteve të përcaktuara në VKM nr.440/2023
- Aneksi 4: Formulari tip i deklarimit të konfliktit të interesit;

ANEKS 1

LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHËM PËR APLIKIM *Informuese*

Kritere të përgjithshme të kualifikimit

- 1. Dokumentin e licencimit për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë nga Banka e Shqipërisë (bashkëngjitur, kopje e noterizuar).
- 2. Ekstrakti nga Qendra Kombëtare e Biznesit (bashkëngjitur, kopje e noterizuar).
- 3. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore për vitin 2023 (bashkëngjitur, kopje e noterizuar).

Kritere të veçanta të kualifikimit

- Deklarata për dakortësinë mbi kushtet e parashikuara në VKM-në 440/2023, sipas Aneksit 3.

Në rast të mosplotësimit të një prej kritereve, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet.

E drejta e Ankimit mund të ushtrohet nga Bankat e Nivelit të dytë, brenda 5 (pesë) ditëve, nga data e njoftimit dhe shpalljes së renditjes nga Komisioni i Vlerësimit dhe Renditjes, në rrugë postare pranë AKFAL.

ANEKSI 2

FORMULARI TIP PËR APLIKIMIN E BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË BANKËS SË NIVELIT TË DYTË

PËRFAQËSUESI LIGJOR: _____

Numri identifikimit personal të përfaqësuesit (sipas Kartës Identitetit / Pasaportës): _____

Banka e Nivelit të Dytë

NIPT

Akti i licensimit

Nr. _____, datë ____ . ____ . _____

Adresa e Selisë:

Propozimi i normës së interesit për kredinë studentore:

Norma e interesit e propozuar: _____ (_____) %

Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i/e vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Autorizoj MAS dhe/ose AKFAL për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit tim.

KËRKUESI

emri, mbiemri, nënshkrimi, vula

E-mail: _____

Nr.cel: _____

ANEKSI 3
DEKLARATË PËR PRANIMIN E KUSHTEVE TË PËRCAKTUARA NË
VKM NR.440/2023

- Deklaruesi: _____
- Unë _____, në pozicionin _____ dhe përfaqësues ligjor i Bankës së Nivelit të Dytë _____, deklaroj se Banka është dakord dhe pranon të jetë pjesë e skemës së kreditimit studentor, duke plotësuar kushtet e parashikuara në VKM nr.440/2023, për kontratën Bankë-Student, e konkretisht:
 - - *kredia studentore do të jepet pa kolateral fizik;*
 - - *kredia studentore do të jepet për mbulimin e kostove vetëm për ndjekjen e një programi studimi;*
 - - *financimi i kredisë do të bëhet me këste, të paktën dy herë në vit, dhe financimi i çdo kësti realizohet vetëm pas konfirmimit nga institucioni i arsimit të lartë, që studenti kredimarrës ka shlyer tarifën vjetore të shkollimit të vitit akademik dhe ka frekuentuar procesin mësimor;*
 - - *detyrimi i shlyerjes së kredisë, përfshirë principalin dhe interesin e kredisë nga studenti kredimarrës, do të fillojë jo më herët se 3 (tre) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të parë; jo më herët se 2 (dy) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të dytë dhe jo më herët se 5 (pesë) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të integruar të ciklit të dytë;*
 - - *norma e interesit të kredisë studentore e propozuar nga Banka jonë është më e ulët se norma mesatare e interesit për kreditë konsumatore, të dhëna nga institucioni ynë për 2 (dy) vitet e fundit, përfshirë vitin në të cilin jepet kjo kredi;*
 - - *norma e interesit të kredisë së propozuar do të jetë e pandryshueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së kredisë.*
- Nënshkrimi _____
- _____
emri, mbiemri, nënshkrimi, vula

ANEKSI 4

FORMULARI I DEKLARIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

- Deklaruesi: _____
- Unë, _____, në pozicionin e _____ dhe përfaqësuesit ligjor të Bankës së Nivelit të Dytë _____, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit, që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi, që mund të çënojë zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes së aplikimeve për financimin e normës së interesit.
- Kjo deklaratë është hartuar më datë _____._____.2023
- Nënshkrimi _____
emri, mbiemri, nënshkrimi, vula

Banka Fituese

Pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes së Bankës nivelit të dytë, komisioni shqyrtoi dhe vlerësoi ofertat për normën e interesit që do të aplikohet për kredinë studentore dhe i renditën ato në bazë të kriterit të normës më të ulët të interesit, përcaktuar në VKM 440/2023.

• **Renditja e bankave sipas kriterit të normës më të ulët të interesit është si më poshtë:**

1. Banka “**Intesa Sanpaolo**”. me normë interesi 6%.
2. Banka “**CREDINS**”. me normë interesi 7%.

2.PROCEDURA E PËRZGJEDHJE SË STUDENTËVE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA SKEMA E KREDITIMIT STUDENTOR.

Shpallja e njoftimit publik për studentët për të paraqitur kërkesat për kredi studentore, në fillim të muajit Shkurt 2024;

Paraqitja e kërkesave për kredi nga studentët brenda muajit Shkurt;

Aplikimi për kredi studentore do të bëhet pranë AKFAL

Vlerësimi dhe renditja e aplikimeve për kredi studentore realizohet sipas kushteve të përcaktuara në VKM 440/2023

brenda muajit mars 2024

a. Kërkesat me vlerën e kredisë më të ulët;

b. Lloji i programit të studimit ku është regjistruar studenti.

Nga kërkesat për kredi, të renditura sipas shkronjës “a”, preferohen kërkesat e paraqitura nga studentët e regjistruar në programe studimi, të përcaktuara si programe prioritare në IIAL publike;

c. Rezultatet e studentit kërkues për kredi studentore.

Kërkesat për kredi studentore, të vlerësuara njëllor të preferuara, do të renditen sipas nivelit më të lartë të rezultateve të studentit që kërkon kredi. Rezultate të studentit, sipas studimeve që ai ndjek.

Përcaktimi i numrit të kërkesave që do të dërgohen Bankave të nivelit të dytë, në rast se numri i kërkesave është më i madh nga fondi në dispozicion.



Rakordimi i numrit të kërkesave për të përfituar kredi studentore, të cilat do të paraqiten te banka/bankat e nivelit të dytë, me fondin që është në dispozicion çdo vit, për financimin e normës së interesit të kredive studentore (0.5% e grantit të mësimdhënies).

Miratimi i numrit të kërkesave, për të cilat do të financohet një pjesë e normës

Njoftimi i Bankës së nivelit të dytë, që ka rezultuar fituese, brenda 15 ditëve nga shpallja e renditjes së kërkesave, për listën e studentëve që do të përfitojnë nga skema e rreditimit

Njoftimi i studentëve aplikues, për vijimin e procedurave dhe nënshkrimin e kontratës së kredisë me Bankën (Brenda të njëtit afat).

3.HARTIMI DHE NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES SË FINANCIMIT : *AKFAL-BANKË*

Hartimi dhe miratimi i modelit të marrëveshjes dhe niveli i financimit të normës së interesit nga për financimin e një pjese të normës së interesit 1 pikë % deri në 5 pikë % (MAS); (

Miratimi i nivelit të financimit të normës së interesit, nga

Nënshkrimi i marrëveshjes së financimit të një pjese të normës së interesit me Bankën e nivelit të dytë që ka rezultuar fituese (Maj 2024).

4.VLERËSIMI I KUSHTEVE TË SKEMËS SË KREDITIMIT, TË KONTRATËS SË KREDISË *BANKË-STUDENT* DHE FINANCIMI I NJË PJESE TË NORMËS SË INTERESIT TË KREDISË.

- Vlerësimi i kushteve të skemës së kreditimit për secilën prej kontratave të kredisë **Bankë-Student** (*brenda 15 ditëve, nga lidhja e kontratës së kredisë ndërmjet Bankës dhe studentit*).
- Përcaktimi i shumës së financimit, për pjesën e interesit të çdo kësti kredie të disbursuar kundrejt studentit, bazuar në nivelin e financimit të përcaktuar në marrëveshjen e financimit, të lidhur nga AKFAL me bankën të nivelit të dytë.
- Xhirimi i shumës së financimit, të përcaktuar dhe miratuar si më sipër, nga AKFAL (ose MAS) në llogari të Bankës së nivelit të dytë.

JU FALEMINDERIT PËR VËMËNDJEN!

PYETJE DHE DISKUTIME